

MALVINA TAFÇIU

**MBI DISA DUKURI FONETIKE NË EMRAT E SHKURTUAR
PËRKËDHELËS E PËRBUZËS NË ANTROPONIMINË
E MAQELLARËS (DIBËR E VOGËL)**

Komuna Maqellarë e gjendur midis dy qyteteve, Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe në lindje të Shqipërisë, ndodhet në Krahinën Malore Qendrore, e ngjuar në të djathtë të lumit Drin i Zi dhe në juglindje të rrethit Dibër. Gërmimet arkeologjike të kryera në këtë zonë dhe në rezultatet e disa kërkimeve historike-kulturore, na flasin për një popullim të kësaj trevë që në lashtësi, në epokën e gurit¹, duke u kthyer kështu në djepin e kulturës dhe të qytetërimit të shqiptarëve. Për këtë ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe pozita e saj gjeografike. Ajo ka qenë dhe është një kryqëzim i rrugëve të kombit, për të shkuar në Shkup, Prishtinë, Tiranë².

Me ndarjen e re administrative të vitit 2013, komuna e Maqellarës tashmë e humbi statusin komunë më vete dhe iu bashkua bashkisë Peshkopi. Aktualisht popullsia e kësaj komune është 13334 me 2894 familje me sip.87.2 km², të cilët janë të shpërndarë në 22 fshatra. **Shkurtimet e emrave të fshatrave:** All për Allejbeginë; Kov për

¹ Gërmimet arkeologjike të kryera në Burim ose **Allajbegi** (fshat në Juglindje të komunës) i cilësuar si vendbanimi i parë në Dibër i epokës e Gurit (neoliti i hershëm), në Çetush (1980), në Topojan (1987-1989, *kultura Topojan I*), *Grazhdan* (ku edhe sot kemi rrënoja të kalasë)¹, në fshatin *Gradec*, që i përkasin shek III-II p.e.s, *Herbel*, qyteti i *Pesakut* (vendbanim i hapur në Jug të fshatit *Klobçisht* të sotëm), *Arra e Livadhit të Madh* (vendbanim në Burim), *Gradishta e Vojnikës* (vend prehistorik dhe antik i vonë, ku është gjetur dhe një stemë rrethore me një shqiponjë me dy krerë të gdhendur në të, mendohej se i perkiste familjes feudale të Gropajve. Shih A. Bunguri, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1989, Topojan (Dibër)*, në "Iliria" 1989/2, f. 262-264; I. Kaca, *Vendbanime prehistorike në rrethin e Dibrës*, në "Iliria", (VII-VIII), f. 307; F. Prendi, 1995, *Të dhëna mbi neolitin e hershëm në zonën e Dibrës*, Lidhja e Historianëve Shqiptarë Dibranë, Dibër, f. 33- 38; A. Bunguri, *Zbulimet arkeologjike në komunën Maqellarë*.

² A. Ademi, *Maqellara – thesar i qëndresës dhe kulturës kombëtare*, Grand Print, Tiranë, 2011, f.3-9.

Kovashicën; *Maj* për Majtarën; *Kër. S.* për Kërçishtin i Epërm; *Kër. P.* për Kërçishtin i Poshtëm; *Kat. Vog.* për Katund i Vogël, *Poc* për Pöcestin, *Pod* për Podgorcën; *Her* për Herbelin; *Çer* për Çernenën; *Kll* për Kllobçishtin; *Bll. Ep.* Për Bllatën e Epërme; *Bll. P. për* Bllatën e Poshtme; *Gr* për Grezhdanin; *Grad* për Gradecin; *Dov* për Dovalanin; *Er* për Erebarën; *Voj* për Vojnikën; *K.B.* për Kurtbegun; *Pes* për Pesjakën; *Pop* për Popinarën; *Maq* për Maqellarën.

Gjatë studimit tonë disavjeçar fokusuar pikërisht mbi onomastikën e kësaj treve, Maqellarën, përfshirë këtu antroponiminë dhe patroniminë, vumë re praninë e emrave personalë në emërtime topike, makro/mikrotoponime qofshin këto. Objekt të këtij punimi do të bëjmë pikërisht disa dukuri fonetike në emrat e shkurtuar përkëdhelës e përbuzës në antroponiminë e Maqellarës (Dibër e Vogël).

Po t'u hedhësh një vështrim veprave të onomasticienëve brenda e jashtë Shqipërisë të bën përshtypje fakti që secili prej tyre ka bërë objekt studimi format e emrave personalë të shfaqura në shumë prej emërtimeve topike të trevës që ato kanë studiuar. Sigurisht në këtë kuadër studiuesit kanë përshkruar edhe motivet shtytëse të këtyre emrave përkëdhelës dhe përbuzës, motive që më gjerësisht i ka përshkruar qartazi studiuesi Gj. Shkurtaj në veprën e tij, konkretisht në sythin "*Shkaqet e lindjes së trajtave II të emrave vetjakë*" dhe *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, në një kapitull kushtuar kësaj kategorie emrash.³

Një përhapje më të gjerë përkëdhelia apo zbunimi ka në emrat vetjakë, ku, në gjuhën e folur, anekand trevave shqiptare, prej shekujsh ka pasur një galdim të përmasave shumë të mëdha të trajtave të dyta të emrave të njerëzve, qoftë me anën e prapashitesave të zvogëlimit e të përkëdhelisë, qoftë edhe me mënyra të tjera, sidomos me anën e shkurtimit të emrave me anën e sinkopimeve, apokopimeve apo të procedurave të përzieria: shkurtim dhe prapashitesim e deri riemërim në kuadrin gjithmonë të përkëdhelisë apo të marrjes me të mirë. Kjo temë, në të vërtetë, i ka tërhequr studiuesit prej shumë vjetësh⁴.

Në punimet e mëparshme kushtuar emrave vetjakë ka pasur edhe sprovë që të gjendet edhe rruga e formimit të këtyre emrave. Studiuesi Palok Daka, me të drejtë, shtronte nevojën e studimit të emrave të këtillë dhe të mënyrës së përhapjes së tyre. Studiuesi përpiquej që për këto trajta të

³ Gj. Shkurtaj, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015, f. 126-139.

⁴ Gj. Shkurtaj, *Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë*, SF, 1977, nr. 2, f. 51- 65.

gjente shpjegime sipas rregullsive fonetike të shqipes, si rënies së tingujve në mes, në fillim apo në fund të emrave apo ndërrimeve të ndryshme tingullore⁵, ndërsa në artikullin e Xh. Lloshit problemi shikohet në një plan tjetër, duke ngulmuar që “emrat e njerëzve formojnë një klasë fjalësh më vete dhe prandaj rregullsitë e ndryshimeve të tyre janë të ndryshme nga rregullsitë e fjalëve të përgjithshme”⁶. Një konstatim i tillë për studiuesin Gj. Shkurtaç, është i drejtë për kundrimin e formimit të emrave vetjakë të shqipes. Megjithatë, na duket që në këtë lëmë ka vend për trajtime të mëtejshme, veçanërisht në gjurmimin e arsyeve të daljes së trajtave të dyta të emrave vetjakë, si dhe lidhur me ndërkalimet e tyre me të parat. Në këtë qasje mendimesh e arsytimesh, studiuesi Gj. Shkurtaç, i mëshon mendimit të shprehur edhe më parë prej tij, se “shtegu i lindjes së trajtave të dyta, qoftë kur marrin prapashtesa, qoftë kur përftohen nga shkurtime a cungime të shoqëruara edhe nga ndërrime tingullore apo edhe me prapashtesa si dhe me anën e riemërimeve ku nuk ka asnjë lidhje fonetike mes trajtës së parë zyrtare dhe trajtës së dytë, ka qenë dhe mbetet në radhë të parë faktori jashtëgjuhësor: zbulimi a përkëdhelia. Ndërkaq, në mjaft raste, ka pasur e ka edhe arsye të tjera, kryesisht jashtëgjuhësore, të cilat vishen me petkun e zbulimit”⁷.

Në studimin tonë nuk po ndalemi të prekim gjerësisht këto arsye pasi, ashtu si edhe për trevat e tjera, edhe për komunën e Maqellarës vlej në përgjithësi po ato arsye, të cilat shkurtimisht vetëm po i përmendim, pa u futur në shpjegime të mëtejshme:

a) Përpjekja për të shmangur emrat shumë të gjatë ose të vështirë për t’u shqiptuar në të folurit e shpejtë dhe në ligjërimin e të vegjëleve, të të moshuarve etj., apo thënë në gjuhën e studiuesit Gj. Shkurtaç “shkurtimi i emrave të gjatë buron edhe nga “ekonomia e gjuhës”⁸.

b) Për arsye të nevojës së mënjanimit të emrave të dyfishuar brenda një familjeje.

c) Me qëllim që të mos e përmendin shpesh emrin e prindit të vdekur para kohe.

d) Për shkak të besimit se, duke ia ndërruar emrin personit të caktuar, do t’i ndërrohet (përmirësohet) edhe gjendja shëndetësore.

e) Për shkaqe të tjera.

⁵ P. Daka, *Disa veçori...*, f. 276.

⁶ Shih: Xh. Lloshi, *art. cit.*, f. 167.

⁷ Gj. Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015, f. 126-127.

⁸ Gj. Shkurtaç, *Po aty*, f. 130.

Prej të dhënave të mbledhura në vendbanime të ndryshme të komunës së Maqellarës, mund të shpjegohet se motivet shtytëse për emërtimin e fëmijëve dhe për krijimin e zbunuesve e të hipokoristikëve në përgjithësi janë të ndryshme, por para së gjithash janë fetare, mistike etj., të shfaqura sit e emrat personal femërorë, ashtu edhe në ato mashkullorë.

Sikurse dihet, formimi i emrave përkëdhelës, në rastet më të shpeshta ndodh në fëmijëri dhe në rrethin e ngushtë familjar, dhe ata emra shuhën dikur në moshën e rinisë. Mirëpo, për arsye se emra të tillë zakonisht kanë edhe afri edhe lidhje fonetike, në këtë artikull do të merremi vetëm me ata emra të veçantë, për riemërtimin e të cilëve motivi shtytës nuk është gjuhësor.

Nuk do të ndalemi në analiza fonetike historike të emrave vetjakë, p.sh. se si ka ardhur *Lam nga Bajram, Sheme nga Shemsi, Avdi e Rahman nga Avdurrahman, Man nga Allaman/ Rrahman Tik nga Adriatik, Rimi nga Nderim e Qerim, Miri nga Mirjan, Jetmir e Sajmir etj.*, sepse ato tashmë janë gjëra të ditura e janë shqyrtuar nga disiplinat përkatëse; përkundrazi, do të merremi me trajtat e dyta të emrave vetjakë, që janë të gjalla edhe sot e gjithë ditën, që shfaqen ditë për ditë në të folurit e shqiptarëve, ashtu si edhe të popujve të tjerë dhe burojnë nga një dukuri jashtëgjuhësore siç është zbunimi apo përkëdhelia. Këto trajta të dyta, të cilat krijohen pa mbarim e në të gjitha mjediset qytetare e fshatare, vijojnë të kenë jetën e tyre të gjallë në gjuhën e folur, kryesisht në mjedis të ngushta familjare e shoqërore, krahas e në konkurrim me trajtat e para apo zyrtare përkatëse.

Dukuri fonetike në emrat e shkurtuar përkëdhelës e përbuzës

Për shkak të larmishmërisë së paraqitjes të emrave përkëdhelës e përbuzës, çështja e ndarjes dhe e klasifikimit të tyre ka shkaktuar një varg dilemash të studiuesit e deritashëm, ndoshta edhe për faktin se shpesh të dhënat nga terreni janë të pakta.

Lidhur me propozimin e Xh. Lloshit që “tek emrat vetjakë të dallojmë dy trajta, një trajtë I (zyrtare ose të mirëfilltë) dhe një trajtë II (të formuar më pas më shkurtime, cungime apo si riemërim)”⁹, Gj. Shkurtaj shkruan se “në parim është i drejtë, mirëpo për t’iu përmbajtur një ndarjeje të tillë, nuk është gjithnjë e lehtë, për arsye se në rrjedhën e viteve mjaft nga trajtat II (të lindura për zbunim), në kushte të ligjëritimit familjar, kanë

⁹ Xh. Lloshi, *Mbi rregullsitë në ndryshimet e emrave të njerëzve*, SF, 1969, nr. 2, f. 165.

marrë shtrirje më të gjerë dhe kanë dalë nga ligjërimi në lëmin e gjerë të së folmes, duke u bërë edhe emra zyrtarë”¹⁰.

Ndërkaq, ndryshe nga studiuesit e përmendur më lartë, Palok Daka¹¹ ka bërë një klasifikim të emrave në nëntë grupe, që s’është e thënë të vlejë edhe për raste të tjera.

Materiali i mbledhur në krahinën e Maqellarës, na lejon klasifikimin e tij në disa grupe, porse një vështrim më i qëmtuar dhe i detajuar i pasqyrimin të antroponimeve në toponimi me siguri se do të na jepte dorë për më tepër grupime, se këto të poshtëshënuara:

Grupi i parë. Në këtë grup hyjnë emrat përkëdhelës në trajtat e të cilëve kanë vepruar dukuritë fonetike, siç janë: afereza, sinkopa dhe apokopa.

a) *Afereza e një a disa tingujve*– Afereza e zanores: *Ajaz* > *Jaz*; *Aqif* > *Qif*, *A/lush* > *Lush*, *Agim* > *Gim*, *I/brahim* > *Brahim*, *A/dem* > *Dem*, *A/lush* > *Lush Akil* > *Kil*, *F(u)at* > *Fat*, *E/jup* > *Jup*, *G(ë)zim* > *Gzim* etj. Ja disa shembuj: (*Lama e Lushit*, *Kopshtijet e Lushit* (Poc); *Ara e Demës* (All); *Bunari i Gzimit* (Pod); *Proja Kilit* (Maj); *Hamlla e Demës* (All); *Blloku i Deme* (K. B); *Mullëjni i Fatit* (Maq); *Ura e Mines* (Kat.Vog.);

– Afereza e dy tingujve: *Sa/dik* > *Dik*, *Ha/lil* > *Lil*, *Ah/met* > *Met*, *Na/dire* > *Dire*, *Sha/tule* > *Tule*, *As/llan* > *Llan*, *Av/dul* > *Dule*, *Li/man* > *Man*, *Ze/nel* > *Nel*, *Se/lim* > *Lim*, *Ah/medat* > *Medat*, *Ri/fat* > *Fat*, *Ni/koll* > *Kol*, *Os/man* > *Man*. Ja disa prej shembujve: *Bunari i Diks* (Voj); *Vneshtat e Memetit* (Voj); *Ara Tules* (Poc); *Pjepat e Liles* (Halil Qoku) (Kll); *Zabeli i Mani* (Gr); *Hourdha e Mani* (Gr); *Hajmalia e Fatit* (Rifatit) (K. B); *Bafshja e Nelit* (Çer); *Ara e Dules* (Dov); *Shpia e Kolës* (Kat. Vog)¹²; (*Her*); *Art e Mdha t’Kols* (Maj)¹³ *Izvori i Kolës* (Kat.Vog.);

Emri i fshatit Allejbegi dhe Kurbeg vijnë nga një antroponimet (emrat personalë) dhe patronimet: *Allaman Begu* dhe *Kurt Begu*, emrat e dy vëllezërve të cilët u vendosën në kohë të hershme në trojet e këtyre fshatrave, prej nga u dhanë atyre edhe emërtimet, apo thënë ndryshe statusi i lartë, grada prej *-beu (begu)* u bë paradigmë e emërtimit të vendbanimit.

¹⁰ Gj. Shkurtaj, *Zbunimi...*, f. 52–53.

¹¹ P. Daka, *Disa veçori...*, f. 282–287.

¹² Këto mikrotoponime m’i ka thënë gjyshi im, i ndieri Myrteza Neziri, gjatë kohës që po merresha me përgatitjen e temës së masterit shkencor, në fushë të dialektologjisë, përkatësisht në vitet 2008-2010, mikrotoponime të cilat nuk i kam hasur ndër informatorë të tjerë gjatë zhvillimit të pyetësorit.

¹³ E. Hysa, QSA, Tiranë, *Ekspedita dialektologjike* 1967.

– Afereza e më shumë se dy tingujve: *Ab/dull/ah* > *Dull* dhe *Abe* (*Bunari* i *Abes* (Çer), *Rama/dan* > *Dan*, *Meh/met* > *Met*, *Shef/qet* > *Çet*, *Muha/rrem* > *Rrem*, *Men/duh* > *Duh*, *Sev/dije* > *Dije*, *Sylej/man* > *Man*, *Jo/nuz* > *Nuz*, *Kap/llan* > *Llan*, *Baj/ram* > *Lam*, *Alla/man* > *Man*, *Za/bit* > *Bit* etj. Ja disa prej shembujve të ndeshura në mikrotoponiminë e zonës: *Pusi Lamit* (Kov); *Mani* i *Danit* (Voj); *Zabeli* i *Lamit* (Kov); *Bafçet e Manit* (Voj); *Trapi* i *Llanit* (Grad); *Brrakat e Lamit* (Kat.Vog.); *Brrakat e Lames* (Pop); *Brraka e Lutes* (Lutfi Asllani) (All); *Art e Llan Lezit* (Maj)¹⁴ *Ogradja e Llan* (*Kapllan*) *Begut* (Maq); *Mani* i *Rremit* (*Ke Mani Rremit*) (Gr); etj.

Siç mund të shihet nga shembujt e shënuar më lart, afereza tek emrat vetjakë në Maqellarë është mjaft e pranishme, madje si tek emrat e gjinisë femërore, ashtu edhe tek emrat e gjinisë mashkullore.

b) *Sinkopa e një a më shumë tingujve.*

Kjo dukuri në trevën e Maqellarës është mjaft e rrallë. Këtu po shënojmë këto shembuj: *(E)m(r)ullah* > *Mullah*, *Ara e Mullait* (Poc); *Ugradja e Mullait* (Poc); *J(ak)up* > *Jup*, *Ara e Jupit* (Dov); *R(ah)im* > *Rimi*. Pra, numri i emrave të përfituar me anë të sinkopës është dukshëm më i vogël se numri i emrave të përfituar me aferezë dhe apokopë.

c) *Apokopa e një a më shumë tingujve:*

Me këtë mënyrë janë formuar emrat: *Xhem/a(i)l* > *Xhem*, *Zen/ullah* > *Zun*, *Lim/an* > *Lim*, *Sel/audin* > *Sel*, *Fat/ime* > *Fatë*, *Sef/ullah* > *Sefë*, *Fat/mir* > *Fat*, *Sal/ihe* > *Salë*, *Lut/fi* > *Lute*, *Naz/mije* > *Naze*, *Bardh/yl* > *Bardh*, *Xhet/an* > *Xhetë*, *Zeq/irja* > *Zeqo*, *Shem/si* > *Sheme*, *Hys/en* > *Hys*, *Mus/a* > *Musë* etj., si p.sh. *Brraka e Lutes* (Lutfi Asllani) (All); *Toka Zeqos*, ara në lindje (Maj)¹⁵ *Prrouja e Zeqes* (Maj); *Mullëjni i Shemes* (Her); *Arrat e Shemës* (Kll); *Arra e Xhetës* (Kll); *Birra e Zunës* (Kërç.P); *Kopshtijet e Limit* (Poc).

Pra, edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një numër të madh emrash të përftuar nga dukuria e apokopës, të cilët tani bëjnë jetën e tyre qoftë si emra vetjakë, qoftë si emra përkëdhelës a përbuzës.

Grupi i dytë. Në trevën e Maqellarës ka një numër të madh emrash të cilët në procesin e shkurtimit ndahen në dy variante të barabarta. P.sh., *Avdul* > *Avdi e Dul*, *Selaudin* > *Sel dhe Din*, *Avdirrahman* > *Avdi e Rrahman*, *Avdirrahim* > *Avdi e Rrahim*, *Ramadan* > *Ramë e Dan*, *Mustafë* > *Musë e Tafë*, *Nuredin* > *Nur e Din* etj.

¹⁴ E. Hysa, QSA, Tiranë, *Ekspedita dialektologjike* 1967.

¹⁵ E. Hysa, QSA, Tiranë, *Ekspedita dialektologjike* 1967.

Grupi i tretë. Një grup të veçantë të emrave vetjakë, përkëdhelës e përbuzës e përbëjnë emrat e përfutur nga shkurtimi a cungimi i trajtave të para të emrave, shoqëruar edhe me ndërrime të tjera fonetike. Emrat e tillë që përmenden në rrethet familjare, janë të shumtë. P.sh. *Sinan* > *Cile*, *Simon* > *Sajme*, *Abdurahman* > *Rrape*, *Muharrem* > *Leme*, *Hasan* > *Can*, *Nikollë* > *Kolë*, *Sadush* > *Tush*, *Hajrie* > *Hajre*, *Munir* > *Mane*, *Hysen* > *Cen*, *Isuf* > *Tuf*, *Shkël/qim* > *Çimi*, *Miftar* > *Tal*, *Baj/ram* > *Lam*, *Meh/met* > *Mete*, *Andrea* > *Antrash* etj. Ja disa shembuj: *Lugu i Ciles* (Dov); *Ködra Hajres* (Çer); *Prrëji i Manes* (Pod); *Toka Manes* (Pod);

Megjithëse të gjitha rastet nuk kanë rregulla të veçanta që do të gjenin zgjidhje të përhershme në fonetikën e gjuhës shqipe, mund të thuhet se disa mundësi ekzistojnë; p.sh., të bie në sy se tingulli *r* gjithkund është asimiluar në *l*, tingulli *s* është asimiluar në *c*, tingulli *ll* ka dhënë *l* etj.

Grupi i katërt. Në këtë grup mund të vendosen emrat përkëdhelës e përbuzës të zgjeruar me prapashtesa. Prej materialeve të mbledhura në terren kemi vënë re se prapashtesa më e shpeshtë që u është shtuar këtyre emrave është *-ush*: *Ramadan* > *Dan* + *-çe* = *Dançe*, *Ramadan* > *Ram* + *-kë* = *Ramkë* *Is/lam* > *Lam* + *-çe* = *Lamçe*, *Ah/met* (*Meh/met*) > *Met* + *-ush* = *Metush*, *Iljaz* > *Laz* > *Las* + *-kë* = *Laskë* *Mer/jeme* > *Leme* + *-kë* = *Lemkë* etj. Ja disa prej shembujve të ndeshura në mikrotoponiminë e zonës: *Teqja Dançes* (All); *Kopshti i Dankës* (Kër.Sip.); *Kthesa e Laskës* (Kat.Vog.); *Kshtenja e Laskës* (Poc); *Lama e Laskës* (Poc); *Çeshma e Laskës* (Kat. Vog.);¹⁶ *Guri Lemkës* (Poc); *Ara e Metushit* (Voj); *Mullëjni i Metushit* (Poc); *Thanat e Lamçes* (Islam Sallahi) (Kll); *Kopshtijet e Lushit* (Poc);

Kësaj çështje i kemi kushtuar një vëmendje të posaçme studimin e doktoratës, ¹⁷kur kemi folur më gjerësisht në kapitullin e emrave përkëdhelës e përbuzës që ndeshim në emërtimet topike të komunës, titulluar “Disa dukuri fonetike që vihen re gjatë procesit të shkurtimit të emrave përkëdhelës e përbuzës”, ndaj këtu nuk po zgjatemi më tepër me dukuritë fonetike. Shkurtimisht po përmendim:

Metateza. Kjo dukuri gjuhësore e ndërrimit të tingujve brenda fjalës në këtë të folme është mjaft e shpeshtë. Metatezën e hasim edhe ndër disa Mikrotoponime të kësaj komune: *Ara Hametit* < *Ahmetit* (Poc), *Pirllaka*

¹⁶ Ky mikrotoponim ka si bazë emrin personal Iljaz, me formën e shkurtuar Las-Laz, e lama afër tij njëhej me emrin Lama e Laskës.

¹⁷ Ky artikull është pjesë e studimit disavjeçar të punimit shkencor, në marrjen e titullit “Doktor”, në korrik 2018 në Universitetin e Tiranës me titull “Onomastika e komunës Maqellarë”.

(Poc) < *Prillaka*, *Gullobornëjk* (Kërç. P.) *Gullubarnëjk*, *Krasta e Gullubarnejkut* (Kërç. P.), *Prrouja e Guruballnejkut* (Kërç. P.), *Glomaniva* < *Gulmoniva* (Poc).

Rënia e grupit nistor të fjalës. Të folmet tona i karakterizon edhe **fenomeni i rënies së tingujve**. Ai haset dendur, si rezultat i mosshqiptimit të disa zanoreve nëpër rrokje të ndryshme të fjalës. Zanorja **ë** në pozicion të patheksuar bie shpesh, por nuk mungon edhe rënia e tingujve të tjerë: *në ballë të fjalës (aferezë)*, *në trup të fjalës (sinkopë)* dhe *në fund të fjalës (apokopë)*, (e gjeni me shembujt përkthës në çështjen e lartpërmendur).

Të tilla mund të sjellim si shembuj: *Ara e Metës* nga Ahmet (All), *Ara Tules* (Poc) nga Shatule, *Ara e Alilit* nga > Halil (Kërç. P.), *Rruga e Axhiarekës* > *Haxhi* (Poc). *Arat e Mani* nga Liman, *Barrakja e Zefit* (nga Josip>Jozef > Zef), *Brraka e Sefës* (Pesj) Sefë>Sefedin>Sejfudin>Sejfullah, *Brrakat e Lamit* (Bajramit) (Kat.Vog.), *Bunari i Hisen Stafës* > Mustaf (Maj), *Trapi i Llanit* > Asllan (Grad), *Hurdha e Mani* > Allaman (Gr) etj. Këtë dukuri e ndeshim edhe në trup të fjalës, p.sh.: *Brraka e Lutës* > Lutfi, *Mullëjni i Llaçës* > Islam, *Bira e Zunës* > Zenullah (Kërç.P.), *Ara e Xhemës* (Kërç. P.) > nga Xhemal, *Stallat e Koprativës* > Kooperativës (Çer) etj.

Elizioni. Si veçori e stilit të bisedimit paraqet zhdukjen e një zanoreje të patheksuar të një fjale, para një zanoreje tjetër të fjalës që vjen pas. Kjo është një karakteristikë që ka përfshirë mbarë stilin e bisedimit, e që është pasojë e ndikimit reciprok të tingujve brenda njësive gjuhësore. Kështu përpara nyjës së përparme **ë** bie nyja e prapme. Kjo dukuri vërehet edhe në disa mikrotoponime të ndryshme të kësaj treve: *Udh'e Dhive*, *Hóurdh'e Dhive*; *Ujt'e Cimburit*, *Ujt'e Xhinit*; *Ujt'e Ftoft te Kurëjtat e Ali Maliqit*; *Ar'e Metës*, *Udh'e Bjeshkës*; *Ujt'e Bjeshkës*, *Ujt'e Bigurit*, *Ujt'e Sudaneceve* etj.

Si përfundim, ashtu si edhe në shumë krahina të tjera të Shqipërisë e trevave shqipfolëse, edhe në krahinën e Maqellarës, do theksuar se emrat përkëdhelës dhe veçanërisht emrat përbuzës nuk kanë arritur të zyrtarizohen shumë, ndoshta edhe për vetë faktin, siç thekson me të drejtë studiuesi B. Baliu se këto emra “nuk bëjnë jetë të gjatë dhe pjesa më e madhe e tyre zbehen deri në moshën 20–25 vjeçare”,¹⁸ porse prania e tyre në mikrotoponimi dhe përgjithësisht në toponime është pothuajse e plotë.

¹⁸ B. Baliu, *Onomastika e Gallapit*, f. 112.

BIBLIOGRAFI

- Ademi, A., *Maqellara – thesar i qëndresës dhe kulturës kombëtare*, Grand Print, Tiranë, 2011.
- Baliu, B., *Onomastika e Gallapit*, Prishtinë, 2015.
- Beci, B., *Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre*, Tiranë, 2002.
- Beci, B., *Të folmet qendrore të gegërishtes*, në “Dialektologjia shqiptare V”, Tiranë 1987.
- Beci, B., *Vendi i së folmes së Dibrës në strukturën dialektore të gegërishtes*, në “Dibra dhe etnokultura a saj”, vëllimi II, Tetovë, 1995.
- Bunguri, A., *Gërmimet arkeologjike të vitit 1989, Topojan (Dibër)*, në “Iliria” 1989/2.
- Çabej, E., *Studime gjuhësore V*. Prishtinë 1975.
- Daka, P., *Disa veçori të formimit të emrave vetiakë në gjuhën shqipe*, në “KDSA”, Tiranë më 12-18 janar 1968, vëllimi III.
- Hysa, E., QSA, Tiranë, *Ekspedita dialektologjike 1967*.
- Kaca, I., *Vendbanime prehistorike në rrethin e Dibrës*, në “Iliria” (VII-VIII).
- Keshi, S., *Disa dukuri për të folmen e Mbiudhës së Maqellarës në Dibër* në “Dialektologjia shqiptare VII”, Akademia Shqiptare e Shqipërisë, IGjL, Tiranë, 2005.
- Lloshi, Xh. *Mbi rregullsitë në ndryshimet e emrave të njerëzve*, SF, 1969, nr. 2.
- Prendi, F., 1995, *Të dhëna mbi neolitin e hershëm në zonën e Dibrës*, Lidhja e Historianëve Shqiptarë Dibranë, Dibër.
- Shkurtaj, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015.
- Shkurtaj, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2015.
- Shkurtaj, Gj., *Zbunimi si shkak i lindjes së trajtave të dyta të emrave vetjakë*, SF, 1977, nr. 2.

